



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 10.7.2019

Lënda: Parashtrime të Komisionerit Publik Florian Ballhysa, në seancën gjyqësore të datës 10.7.2019 para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 46, datë 24.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Xhezair Zaganjori, gjyqtar/kryetar i Gjykatës së Lartë.

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5, i Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në lidhje me prapësimet e subjektit të rivlerësimit, z. Xhezair Zaganjori, të paraqitura në seancën e kaluar, referuar edhe përmbajtjes së procesverbalit të seancës gjyqësore, Komisioneri Publik vlerëson se, për sa i takon shkaqeve të ankimit, të cilat kanë të bëjnë me interpretime ligjore të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, nuk rezulton të ketë ndryshuar asnjë rrethanë.

Referimi i subjektit të rivlerësimit, në përmbajtjen e një manuali të përgatitur nga një grup autorësh, në vlerësimin e Komisionerit Publik, nuk merr mbivlerë të shtuar, në raport me jurisprudencën e deritanishme, të prodhuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në lidhje me elemente të tilla të rivlerësimit, si: (i) burimi i ligjshëm; (ii) të ardhurat e ligjshme; (iii) raporti i Deklaratës Vetting me deklaratimet periodike të pasurisë etj.

Komisioneri Publik vlerëson se, edhe pas prapësimeve të paraqitura nga ana e subjektit të rivlerësimit, shkaqet e ankimit të lidhura me interpretimet ligjore, që përdoren nga Komisioni në vendimin e konfirmimit, mbeten të gjitha për t’u marrë në shqyrtim e për t’u gjykuar nga ana e këtij trupi.

Ndërkohë, lidhur me provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur prapësimeve të tij për shkaqet e ankimit, Komisionerit Publik, nga ana e trupit gjykues, i janë përcjellë aktet vijuese:

1. Deklaratë noteriale (nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.2.2019), të 4 bashkëpronarëve dhe bashkëshortëve të tyre, lidhur me ndërtimin dhe administrimin e godinës së ndërtuar së bashku në vitin 1997. Kontratë e sipërmarrjes, lidhur në gusht 1997 (**prova nr. 1**).
2. Kontratë e sipërmarrjes, e njësuar me origjinalin nga noteri, lidhur në *** gusht 1997, “Për ndërtimin e banesës pesëkatëshe në rrugën “***.***.***”, Tiranë, mes palëve: Familjet *** dhe ***, të përfaqësuara nga znj. ***.***, nga njëra anë, dhe firmës private “****” sh.p.k., me qendër Tiranë, përfaqësuar nga presidenti i saj z. ***.*** (**prova nr. 2**).
3. Kontratë e noterizuar ndërmjet subjektit të rivlerësimit me filialin elektrik, e datës *** dhjetor 1997, për furnizimin e apartamentit të tij në godinën e re me energji elektrike (**prova nr. 3**).
4. Dy fotografi të noterizuara të vitit 1998 dhe 1999, të godinës dhe ballkonit (**prova nr. 4**).
5. Deklaratë e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., për pagesën e tatimit në burim për qiratë e vitit 2005-2006 (**prova nr. 5**).
6. Vërtetimet e pagesës nga Instituti ***.***, në ***/Gjermani (me vulë apostile) (**prova nr. 6**).
7. Vërtetim punësimi nga Fakulteti i Drejtësisë të UT-së, për periudhën 1981-1992 dhe 1999-2003 (**prova nr. 7**).
8. Vërtetim pagese nga Fakulteti i Drejtësisë të UT-së për periudhën 1991-1992 (**prova nr. 8**).
9. Vërtetim pagese nga Fakulteti i Drejtësisë të UT-së për periudhën 2009-2016 (**prova nr. 9**).
10. Vërtetim pagese nga Shkolla e Magjistraturës për periudhën 2000-2002 (**prova nr. 10**).
11. Vërtetim page nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme për vitet 1992-1997 (**prova nr. 11**).
12. Lëvizjet e llogarisë pranë ***.***.*** Bank (**prova nr. 12**).
13. Vërtetim nga ISSH-ja për bashkëshorten, znj. ***.*** (**prova nr. 13**).
14. Vërtetim punësimi për bashkëshorten, znj. ***.***, në vitet 1989-1992 (**prova nr. 14**).
15. Libreza e punës së bashkëshortes me shënimet përkatëse nga viti 1989 (**prova nr. 15**).
16. Vërtetim për qiranë mujore në konvikt studentor, në vitet 2014 – 2017, të djalit ***.***, në Gjermani (**prova nr. 16**).
17. Vërtetim për qiranë mujore në banesë, për vitet 2017 e vijim, të djalit ***.***, në Gjermani (**prova nr. 17**).
18. Vërtetim për pagesat semestrale universitare të djalit ***.***, nga semestri dimëror 2013 deri në semestrin veror 2019 (**prova nr. 18**).
19. Vërtetim bankar për llogarinë e djalit ***.***, në vitin 2014 (**prova nr. 19**).
20. Vërtetim nga Banka ***, ku thuhet se Gjykata e Lartë nuk ka kartë krediti, por vetëm llogari buxhetore (**prova nr. 20**).
21. Vërtetim nga Gjykata e Lartë, ku vërtetohet se ky institucion nuk ka disponuar asnjëherë kartë krediti (**prova nr. 21**).
22. Katër vërtetime për përdorimin e kartës personale në emër të institucionit Gjykata e Lartë (**prova nr. 22**).
23. Dy vërtetime nga Fondacioni ***, ku vërtetohet se shpenzimet e dy aktiviteteve janë mbuluar prej tyre (**prova nr. 23**).

A. Për katër pasuritë, me adresë rruga “***.***.***”, Tiranë

A.1 Lidhur me shkakun e ankimit për **deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme** të subjektit të rivlerësimit për katër pasuritë, në adresën “***.***.***”, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar (provat nr. 1-4, sipas inventarit), nga subjekti rezulton se:

1.1 Sipas **provës nr. 1**, deklaratë noteriale e katër bashkëpronarëve *** dhe ***, dhe bashkëshortët e tyre/bashkëpronarë, parashtrohet fakti se katër çiftet (deklaruesit dhe bashkëshortët) kanë financuar në pjesë të barabarta për ndërtimin e godinës nëpërmjet znj. ***.***, e cila ishte njëkohësisht përfaqësuese e autorizuar e z. ***.*** dhe znj. ***.***, si pronarë të truallit dhe zhvillues të godinës. Sipas deklaratës, znj. ***.*** i ka përfaqësuar bashkëpronarët në nënshkrimin e çdo kontrate të nevojshme, si dhe është marrë me administrimin e njësive të përbashkëta. Në këtë deklaratë specifikohet se kontratat e shitblerjes të vitit 2001 janë akte formale për kalimin e pronësisë nga pronarët, z. ***.*** dhe znj. ***.***, te bashkëpronarët aktualë, përfshirë dhe subjektin e rivlerësimit.

1.2 Bazuar në përmbajtjen e kësaj deklarate noteriale, lidhur me të ardhurat e përfituara nga qiradhënia nga viti 1997, bashkëpronarët deklarojnë se pagesat nga “***.***.***” janë bërë në llogarinë bankare të znj. ***.***, në një bankë në Selanik (1997-2003) dhe në llogarinë bankare të znj.***.***, në bankën ***.***, nga viti 2003 - qershor 2006. Bazuar në përmbajtjen e deklaratës noteriale, pretendohet se detyrimet tatimore janë paguar nga znj. ***.*** dhe të ardhurat vjetore të përfituara nga këto kontrata janë ndarë më pas midis personave të tjerë. Subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ligjor të ri justifikues, për të provuar pagimin e detyrimeve tatimore për këtë periudhë, për të ardhurën e realizuar nga qiraja, e cila deklarohet pjesërisht si burim krijimi i pasurive në fjalë. Subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument edhe në lidhje me mënyrën e transferimit të pjesës takuese nga z.***.*** te bashkëshortët Zaganjori.

1.3 Për sa i takon pjesës takuese të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, në të njëjtën deklaratë noteriale, pretendohet se vlera e qirasë ka filluar t’ju jepet nga janari 1999, pasi përpara kësaj periudhe kjo pjesë takuese e tyre shkonte pjesërisht për të kompensuar bashkëpronarët që kishin investuar më tepër dhe pjesërisht për investime/rregullime në hapësirat e objektit.

1.4 Në vlerësimin e **Komisionerit Publik**, kjo deklaratë noteriale e paraqitur nga subjekti gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit në Kolegj, nuk sjell ndonjë risi dhe nuk pasqyron ndonjë fakt/rrethanë juridike, që nuk ishte deklaruar më parë nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ të Komisionit, fakte këto, të cilat Komisioneri Publik i ka shqyrtuar në ngritjen e këtij ankimi, duke i konsideruar të nivelit deklarativ. Të tilla ato mbeten edhe pas dorëzimit të provave gjatë prapësimeve të subjektit.

1.5 Sipas **provës nr. 2**, rezulton se znj. ***.***, duke marrë tagret e përfaqësimit të familjes ***.*** (megjithëse nuk na rezulton ndonjë akt formal përfaqësimi i administruar), ka nënshkruar një kontratë sipërmarrje me shoqërinë “***” sh.p.k., me seli në Tiranë. Kontrata është me afat *** gusht 1996 - *** mars 1997. Kontrata rezulton të jetë lidhur vetëm për realizimin punimeve karabina dhe vlera e punimeve (*e cila nuk pasqyrohet në kontratë*) do të bëhej në bazë të volumeve të punimeve, dhe pagesa do të bëhej me lekë në dorë, kundrejt situacioneve ...

1.6 Referuar përmbajtjes së kontratës së paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pjesë përbërëse e saj, kontratës, në momentin e nënshkrimit kanë qenë dhe (i) projekti i ndërtimit e (ii) preventivi. Këto dy dokumente (projekti dhe preventivi) nuk janë vënë në dispozicion nga ana e subjektit të

rivlerësimit, për të verifikuar edhe vlerën e investimit, nisur nga pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet e subjektit (DV- 2003 dhe D-Vett), si një nga shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik.

1.7 Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se pronësia mbi sendin është përfituar me bashkim e përzjerje, sipas nenit 173 të K. Civil

Meqë këmbëngulet nga subjekti i rivlerësimit në këtë argument, modestisht, do t'i kërkoja këtij trupi gjykues t'i referohet tre elementeve: (i) përmbajtjes së nenit 173 të K. Civil, ku flitet për **pronësi mbi tokën ku ndërtohet** (pronësi të cilën asnjë nga bashkëpronarët aktualë nuk e ka pasur mbi truallin gjatë periudhës kur është ngritur godina); (ii) një sërë ligjeve, akteve nënligjore dhe rregulloresh të fushës së planifikimit dhe rregullimit të territorit, që kanë qenë në fuqi në momentin e ndërtimit dhe që përbëjnë *lex specialis* e të cilat nuk mund të pretendohet se nuk sjellin asnjë pasojë juridike, duke u mjaftuar me referimin vetëm në nenin 173 të K. Civil; (iii) faktit se në vitin 1996 z. *****.*** dhe znj. ***.*** nuk kanë qenë pronarë të të gjithë sipërfaqes së truallit mbi të cilën është ndërtuar godina**, pasi vetëm 207 m² i janë kthyer me vendim të KKKP (vendim nr. 727, datë 20.9.1994), ndërsa për pjesën tjetër të sipërfaqes prej 592 m², iu është njohur vetëm pronësia. Vetëm në vitin 2001, në 13 mars, KKKP (vendim nr.10, datë 13.3.2001), duke njohur si fakt të kryer zënien e të gjithë sipërfaqes së ndërtimit nga godina tashmë e përfunduar, u ka kthyer në pronësi edhe pjesën tjetër të truallit, me qëllim regjistrimin e në ZVRPP Tiranë.

1.8 Përfundimisht, për këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë provë, akt apo prezantuar ndonjë rrethanë të re juridike në lidhje me: **(i) vlerën e paguar për ndërtimin e godinës, (ii) subjektet që kanë paguar për ndërtimin e godinës; (iii) mënyrën e pagesës së vlerës së punimeve; (iv) preventivë, fatura, situacione apo çdo lloj akti tjetër për të vërtetuar deklaratimet për sa i takon: a) shumës totale të investimit, b) kohës së kryerjes së tij dhe për rrjedhojë c) aftësinë financiare për të mbuluar me të ardhura të ligjshme këtë pasuri të deklaruar nga ana e tij, në kohën e krijimit të saj.**

1.9 **Prova nr. 3**, kontrata me KESH-in, është një dokument i paraqitur edhe më parë nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ të Komisionit.

1.10 **Prova nr. 4**, subjekti ka paraqitur 2 fotografi, të cilat, në këndvështrim të Komisionerit Publik, janë fakte që nuk provojnë të kundërtën e shkaqeve të ankimit.

A.2 Lidhur me shkakun e ankimit **për pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive**, deri në mesin e vitit 1999 (sipas deklaratimeve të subjektit), nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti (provat nr. 6-8, prova nr. 11 dhe provat nr. 13-15) rezulton se:

2.1 **Prova nr. 6.** Megjithëse dokumentacioni i paraqitur rishtazi nga subjekti i rivlerësimit për bursën e marrë nga Instituti *****.***** rezulton të jetë paraqitur me vulë apostile, sikundër kërkohet nga legjislacioni shqiptar, në vlerësim të Komisionerit Publik mbetet e paprovuar shuma e kursyer, si dhe mënyra e dërgimit të saj në Shqipëri, e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në vlerën 2.6 milionë lekë, deri në mesin e vitit 1999.

2.2 Gjatë parashtrimeve të tij, subjekti, në mënyrë deklarative, shpjegoi se të ardhurat e përfituara nuk kanë qenë thjesht një bursë, por e ardhur nga një projekt ku ai ishte përfshirë. Sipas subjektit, shuma e akorduar ishte e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës dhe se: *në rastin më të keq, nga kjo bursë ka tepruar vetëm gjysma dhe se shpenzimet e qirasë, drita, ujë nuk kalonin 900 marka.*

Në vlerësimin e Komisionerit Publik, pretendimet e subjektit mbi nivelin e kursimeve nga e ardhura në formë burse mbeten në nivel deklarativ. Subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion/provë mbi shpenzimet e jetesës për kohën, nivelin e kursimeve të realizuara nga këto të ardhura apo mënyrën e depozitimit të këtyre kursimeve në sistemin bankar (duke qenë se pagesa në formë burse kalonte nëpërmjet sistemit bankar).

Subjekti, gjithashtu, nuk ka arritur të provojë mënyrën e dërgimit të kursimeve të pretenduara në Shqipëri, referuar kërkesave të udhëzimit nr. 4095/2016 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, lidhur me mënyrën e transferimit të vlerave monetare nga jashtë vendit.

2.3 Nga analiza e **provave nr. 7, nr. 8 dhe nr. 11**, rezulton se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit për periudhën deri në fund të vitit 1997 janë respektivisht:

- Për periudhën ***.12.1991 – ***.8.1992, të ardhurat e subjektit nga paga pranë UT-së, Fakulteti i Drejtësisë janë në total në shumën 11.400 lekë (**prova nr. 8**).
- Për periudhën janar 1993 – tetor 1997, të ardhurat e subjektit nga paga si ambasador i Republikës së Shqipërisë rezultojnë (**prova nr. 11**) në vlerën totale 7.771.350 lekë¹ bruto dhe 6.141.583 lekë neto (pas zbritjes së detyrimeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore, bazuar në legjislacionin e kohës²).
- Për periudhën 1990-1993, bashkëshortja e subjektit ka realizuar të ardhura nga punësimi (sipas **provave nr. 14 dhe nr. 15**) në shumën 64.680 lekë.

2.4 **Provat nr. 9, nr. 10 dhe nr. 13** i përkasin të ardhurave të realizuara pas gushtit 1999 dhe nuk janë relevante për analizën e pasurive në adresën rr. “***.***.***”.

2.5 Në analizë të fakteve të reja të vëna në dispozicion, referuar deklaramete të subjektit të rivlerësimit për dërgimin e shumës prej 2.5 milionë lekësh deri në mesin e vitit 1996 rezulton se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë realizuar të ardhura për periudhën 1991-1997 në shumën totale 6.217.662 lekë.

2.6 Për të ardhurat e realizuara deri në vitin 1992 vlerësojmë se gjithë të ardhurat familjare janë shpenzuar për konsum. Rrjedhimisht, të ardhurat e subjektit që kanë shërbyer për të pretenduar krijimin e kursimit të deklaruar deri në mesin e vitit 1996, janë në shumën 3.860.090 lekë (të llogaritura të ardhurat janar 1993 - qershor 1996).

2.7 Shuma e deklaruar e kursyer, në vlerën 2.5 milionë lekë, e dërguar për të investuar në pasuritë e analizuara më sipër, është rreth 66% e totalit të të ardhurave të realizuara, raport ky relativisht i lartë kursimi.

2.8 Lidhur me këto kursime/investime, rezulton gjithashtu se mbetet e paprovuar mënyra e dërgimit të tyre në Shqipëri, referuar kërkesave të udhëzimit nr. 4095/2016 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, lidhur me mënyrën e transferimit të vlerave monetare nga jashtë vendit.

2.9 Në përfundim të analizës së provave/akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për këtë shkak të ankimit, Komisioneri Publik vlerëson se provat e paraqitura nga subjekti nuk

¹ Shumat e konfirmuara nga Ministria e Europës dhe Punëve të Jashtme të konvertuara me kursin mesatar vjetor të çdo viti sipas arkivit të kurseve të këmbimit, Banka e Shqipërisë.

² Për llogaritjen e masës së sigurimeve shoqërore jemi bazuar në: ligj nr. 7703, datë 11.5.1993, VKM nr. 452, datë 16.9.1993 dhe VKM nr. 42, datë 23.1.1995; Për llogaritjen e tatimit mbi të ardhurat personale jemi bazuar në: ligjin nr. 7585, datë 14.7.1992, ligjin nr. 7786, datë 27.1.1994, ligjin nr. 7897, datë 2.2.1995, ligjin nr. 8091, datë 21.3.1996.

*pasqyrojnë ndonjë vlerë të shtuar lidhur me provueshmërinë e fakteve për të cilat është ngritur ankimi, pasi subjekti nuk ka mundur të provojë me dokumentacion (preventiv/situacion) vlerën e investimit të bërë në këtë objekt, mënyrën e pagesës (fatura/mandate bankare), si dhe nuk ka provuar pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e realizuara nga qiraja me “***.***.***”, për periudhën 1997-1998, periudhë në të cilën deklarohet se të ardhurat nga qiraja kanë shërbyer si burim krijimi të këtyre pasurive.*

2.10 Subjekti nuk ka provuar burimin e ligjshëm të kursimeve të deklaruar, të përdorura për krijimin e pasurive si më sipër analizuar (të dërguara nga Gjermania), si dhe lidhur me këto kursime të pretenduara, mbetet e paprovuar mënyra e dërgimit të tyre në Shqipëri, në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr. 4095/2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, lidhur me mënyrën e transferimit të vlerave monetare nga jashtë vendit.

B. Të ardhurat nga qiraja

3. Për të ardhurat nga kontrata me qiramarrës “***.***.***”, referuar nenit D, pikat 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë provë/dokumentacion për të provuar se këto ardhura duhen konsideruar si të ardhura të ligjshme, për periudhën 1997-1998 (sikundër trajtuar më sipër në burimin e pasurive, me adresë rr. “***.***.***”, si dhe për periudhën janar 1999 - dhjetor 2005, në shumën totale 60.480 USD). Asnjë provë nuk është paraqitur rishtas nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me vërtetimin e transferimit të të ardhurave të përfituara nga kjo qira nga znj. ***.***, te subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij.

4. Për të ardhurat nga kontrata me qiramarrës “***”, referuar nenit D, pikat 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë provë/dokumentacion për të provuar se këto ardhura duhen konsideruar në mesin e të ardhurave të ligjshme, për vitin 2007 në shumën 1,200.00 euro.

5. Të ardhurat nga kontrata me qiramarrës shoqërinë “***” **sh.p.k.**

5.1 Për të ardhurat nga qiratë, nga qiradhënësi shoqëria “***” sh.p.k., për vitet **2005** dhe **2006**, subjekti ka vënë në dispozicion shkresë-vërtetim të shoqërisë “***” sh.p.k. të datës ***.6.2019 (**prova nr. 5**), sipas së cilës konfirmohen shumat neto të qirasë së paguar, të deklaruar edhe në shkresën e mëparshme të administruar në dosjen e Komisionit (të datës 25.4.2016).

5.2 Shoqëria ka deklaruar shlyerjen e detyrimeve tatimore, si dhe faktin se shumat e detyrimeve tatimore, që i takojnë të ardhurave nga qiraja për subjektin e rivlerësimit, nuk përputhen me lëvizjet e llogarive/pagesave të vëna në dispozicion, pasi në këto të fundit është përfshirë edhe tatimi në burim për qira te tjera të derdhura nga shoqëria.

5.3 Në cilësinë e provës, subjekti ka paraqitur dhe lëvizje llogarie të kësaj shoqërie pranë bankës ***.*** (sot ***), ku evidentohet pagesa e detyrimeve tatimore për tatimin në burim.

5.4 Nga verifikimi i këtyre akteve, në pagesën e datës ***-jan-05 (me numër reference ***) rezulton se përshkrimi i veprimit të kryer është: “*tatim mbi qira, ***.*** dhe ***.*** 6-mujori i dytë i vitit 2004 (600\$)*”. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore nuk rezulton që për këtë periudhë subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar të ardhura nga qiraja nga kjo shoqëri apo të jetë depozituar kontratë qiraje.

5.5 Pagesat e tjera të vëna në dispozicion kanë përshkrime të veprimeve që nuk konfirmojnë periudhën për të cilën janë deklaruar shlyerjet e tatimit në burim të të ardhurave nga qiraja, konkretisht: (i) pagesa me nr. reference *** ka përshkrimin: pagesë për periudhën ***.04.05 - ***.05.05; (ii) pagesa me nr. reference *** , për periudhën qershor-dhjetor 2005; (iii) pagesa me nr. reference *** rezulton pagesë e periudhës nëntor 2005, por nuk specifikohet kujt muaji i takon; (iv) pagesa me nr. reference *** rezulton pagesë e periudhës dhjetor 2005, por nuk specifikohet kujt muaji i takon; (v) pagesa me nr. reference *** ka përshkrimin: *tatim mbi qira muaji qershor 06*.

5.6 Sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur nga subjekti nuk provon shlyerjen e detyrimeve tatimore për gjithë periudhën 2005 dhe 2006, për të ardhurat e deklaruara në **shumat 4,800.00 USD dhe 2,160.00 euro**.

5.7 Për vitin **2007**, për të ardhurën nga qiraja në shumën **270,000.00 lekë**, subjekti nuk ka paraqitur asnjë provë/dokumentacion për të provuar shlyerjen e detyrimeve tatimore.

5.8 Në përfundim të analizës së provave/akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për këtë shkak të ankimit, Komisioneri Publik vlerëson se provat e paraqitura nga subjekti për të ardhurat nga qiratë për periudhat si më sipër, referuar nenit D, pikat 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës nuk provojnë burimin e ligjshëm dhe ligjshmërinë e tyre.

C. Pasuria në *, plazh, Durrës**

6. Për pasurinë “Apartament” me sipërfaqe **81 m²**, ***, **plazh Durrës**, subjekti ka paraqitur si provë të re lëvizjet e llogarisë dyemërore (në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij) pranë *** Bank (**prova nr. 12**).

7. Ky dokument (*i cili rezulton i paraqitur edhe përpara Komisionit gjatë hetimit administrativ*) paraqet lëvizjet e llogarisë së subjektit dhe bashkëshortes së tij për periudhën ***.8.2008-***.7.2012, periudhë e cila nuk korrespondon me periudhën e blerjes së pasurisë (***.6.2006), për të vërtetuar tërheqjen e pretenduar nga subjekti, në referencë të shkakut të ankimit.

8. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur vërtetim nga ISSH-ja me nr. *** prot., datë ***.1.2019 (**prova nr. 13**), për të ardhurat e bashkëshortes për periudhën gusht 1999 - qershor 2005, pranë shoqërisë “****” sh.p.k., në shumën totale prej 1,448,984 lekë. Bazuar në këtë provë të administruar, të ardhurat e bashkëshortes për këtë periudhë konsiderohen të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës.

*9. Në përfundim të analizës së provave/akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për këtë shkak të ankimit, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të bashkëshortes nga shoqëria “****” sh.p.k., por vërtetohet se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin pasurisë apartament në ***, plazh, Durrës, përderisa nuk konfirmohet tërheqja e shumës prej 16,000 USD nga llogaria bankare, sipas deklarimeve të vetë subjektit.*

D. Shpenzimet e shkollimit dhe jetesës të personave të lidhur, z. *,*** dhe ***,*****

D.1 Lidhur me personin e lidhur (djali) z. *,*****

10. Subjekti nuk ka paraqitur asnjë provë/dokumentacion justifikues ligjor për të provuar kostot/shpenzimet e shkollimit dhe jetesës për periudhën 5-vjeçare, 2008-2013, në Mbretërinë e Bashkuar.

D.2 Lidhur me personin e lidhur (djali) z.*.*****

11. Subjekti ka paraqitur provat **nr. 16-19**. Nga verifikimi i këtyre akteve, rezulton se subjekti ka paraqitur dokument me vulë apostile të “Ndërmarrje studentore” Munihi, më anë të të cilit vërtetohen kostot e qirasë së djalit të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2013-2017, si dhe një dokument të lëshuar nga Universiteti ***.*** Munihi, mbi shpenzimet semestrale për periudhën 2013-2019.

11.1 Nga aktet në dosje rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të provuar kostot/shpenzimet e shkollimit dhe jetesës për periudhën 2013-2016, dhe shpjegimet e tij mbeten në nivelin e pretendimeve të paprovuara.

*12. Në përfundim të analizës së provave/akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për këtë shkak të ankimit, Komisioneri Publik vlerëson se, referuar nenit D, pikat 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, dhe ka mungesë burimesh të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e shkollimit dhe jetesës të personave të lidhur, ***.*** dhe ***.***. Nga analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit për këto vite, ka rezultuar se subjekti nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet për periudhën 2011-2014³.*

E. Të ardhurat e viteve 2011, 2012 dhe 2014

13. *Për vitet 2011, 2012, 2014*, për të cilat ka rezultuar se subjekti nuk mbulon me burime të ligjshme kursimet dhe shpenzimet, rezulton se subjekti ka paraqitur dokumentacion për rishikimin e shpenzimeve nga karta e kreditit (**provat 20-23**).

14. Pas analizimit të provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit u zbritën shpenzimet e kartës së kreditit për vitin 2014, në shumat 1.739 euro, 129.98 euro dhe 649 euro. Shumat e tjera të pretenduar nga subjekti prej 1.094.55 euro, sipas shkresës datë ***.2.2018 dhe 480 euro (**prova nr. 23**), nuk ishin të përfshira në shpenzimet/pagesat e kartës së vitit 2014, pasi kanë qenë udhëtime pune të subjektit, deklaruar më parë dhe si të tilla dhe nuk janë përfshirë as në shpenzimet e kartës dhe as në shpenzimet e udhëtimit të subjektit.

15. Pas rishikimit të shpenzimeve të rimbursuara rezulton se diferenca negative në mbulimin e të ardhurave për vitin **2014** llogaritet në shumën - 538,979.67 lekë nga - 891.772.31lekë dhe diferenca totale negative e viteve 2011, 2012 dhe 2014 rezulton në shumën - 2.101.016 lekë.

16. Subjekti, gjatë parashtrimeve të tij në seancën e datës 25.6.2019, deklaroi se për mbulimin e shpenzimeve vjetore është përdorur dhe shuma prej 900.000 lekë, kursime të administruara në banesë, në *cash*.

17. **Në vlerësim të Komisionerit Publik**, subjekti ka qenë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së që nga viti 2003. Mbështetur në ligjin nr. 9049/2003 “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe udhëzimeve të tij, subjekti duhet të deklaronte në deklaramet periodike vjetore çdo ndryshim në

³ Për më tepër referohu pikës E.

pasuritë e tij. Mbështetur në këtë ligj, në pasuri bëjnë pjesë si pasuritë e paluajtshme, ashtu dhe pasuritë e luajtshme, përfshirë dhe likuiditetet në *cash*. Nga verifikimi i deklarimeve periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit, rezulton se subjekti ka deklaruar kursime në *cash* në vlerën 300.000 lekë në vitin 2003 dhe në vlerën 600.000 lekë në vitin 2004, dhe më tej në vitet në vazhdim nuk ka deklaruar më ndryshime, shtime apo pakësime të këtyre likuiditeteve. Nga analiza e deklaratave periodike vjetore, të ardhurave të ligjshme, shpenzimeve të jetesës dhe shpenzimeve të tjera si shpenzime udhëtimi, shpenzime të evidentuara nga karta e kreditit, pa përfshirë ato për të cilat subjekti ka provuar të kundërtën, nuk rezulton që ai të ketë deklaruar ndryshime (pakësime) të kursimeve në *cash*, të cilat gjithsesi janë më të vogla se diferenca e konstatuar në vitin 2012 prej rreth 1.3 milionë lekë.

18. Në përfundim të analizës së provave/akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për këtë shkak të ankimit, Komisioneri Publik vlerëson se, referuar nenit D, pikat 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, rezulton se për këto vite subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të mbuluar shpenzimet dhe kursimet, për një total diference negative për këto vite, prej 2.101.016 lekë.

Duke i qëndruar të gjithave shkaqeve të ankimit të paraqitur, Komisioneri Publik i kërkon këtij trupi të shprehet mbi kërkimin përkatës.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA